<p>2.2. Programet plotësuese të trajnimit janë programe të miratuara, që nuk ndërlidhen drejtpërdrejtë me metodologjitë e mësimdhënies, por janë në interes të sigurimit të cilësisë në shkollë, zhvillimit dhe avancimit të punës në shkollë.</p>	<p>2.2. Additional training programs are approved programs but not directly related to teaching methodologies but are in the interest of quality assurance in school, development and advancement of work in school.</p>	<p>2.2. Dodatni programi obuke su odobreni programi, ali koji nisu direktno povezani sa nastavnim metodologijama, već su u interes obezbedivanej kvaliteta u školi, razvoju i unapređenju rad u školi.</p>
<p>3. Programet plotësuese të trajnimit mund të shërbejnë/mbulojnë maksimum deri në 30% të kërkeseve për orë të trajnimit në sistemin e licencimit. Pjesa tjetër është e domosdoshme të jetë nga programet themelore që lidhen me mësimdhënien dhe të nxënët.</p>	<p>3. Additional training programs can serve / cover up to 30% of the training time requirements in the licensing system. The rest is necessary to be from the basic programs related to teaching and learning.</p>	<p>3. Dodatni programi obuke mogu poslužiti / pokrije maksimalno do 30% zahteva za časove obuke u sistemu licenciranja. Ostatak je neophodano da bude iz osnovni programi vezano za nastavu i učenje.</p>

Neni 16 Llojet e licencave	Article 16 Types of licenses	Član 16 Vrste licence
<p>1. Sistemi i licencimit përcakton katër lloje të licencave:</p> <ul style="list-style-type: none"> 1.1. Licenca për mësimdhënës të karrierës; 1.2. Licenca për mësimdhënës të avancuar; 1.3. Licenca për mësimdhënës mentor, dhe 1.4. Licenca për mësimdhënës të merituar. 	<p>1. The licensing system defines four types of licenses:</p> <ul style="list-style-type: none"> 1.1. License for career teacher. 1.2. License for advance teachers. 1.3. License for mentor teacher and 1.4. License for meritorious teachers. 	<p>1. Sistem licenciranja definiše četiri vrste licenci:</p> <ul style="list-style-type: none"> 1.1. Licenca za nastavnika karijere 1.2. Licenca za napredan nastavnik 1.3. Licenca za nastavnik mentor, i 1.4. Licenca za zasluzni nastavnik.
Neni 17 Kriteret për lëshimin e licencës së mësimdhënësit të karrierës	Article 17 Criteria for license issuance of the career teacher	Član 17 Kriterijumi za izdavanje licence za nastavnikë karijere
<p>1. Deri në zbatimin e fazës hyrëse në profesionin e mësimdhënësit dhe zbatimin e Ligjit për Profesionet e rregulluara, mësimdhënësit/personat e diplomuar kanë të drejtë kandidimi dhe punësimi pa licencë të mësimdhënësit.</p>	<p>1. Until the implementation of the introductory phase into the teacher's profession and the implementation of the Law on Regulated Professions, teachers / graduates have the right to nomination and employment without a teacher's license.</p>	<p>1. Do uvođenja uvodne faze u profesiji nastavnika i sprovodenje Zakona o regulisanim profesijama, nastavnici / diplomirana lica imaju pravo da se kandiduju i zaposle bez licence nastavnika.</p>

<p>2. Pas përvojës njëvjeçare në profesionin e mësimdhënësit aplikojnë për licencë të karrierës me dëshmitë në vijim:</p> <p>2.1. Diplomën e kualifikimit;</p> <p>2.2. Vërtetimin për punë njëvjeçare në institucionet e arsimit parauniversitar në lëndën\fushën e kualifikimit;</p> <p>2.3. Raportin e vlerësimit nga drejtori i shkollës.</p> <p>3. Licenca e mësimdhënësit të karrierës duhet të ripërtërihet pas pesë vitesh, me kusht që mësimdhënësi të tregoj rezultate pozitive të performancës (niveli: performance e kënaqshme në kuptim të shkallës së vlerësimit të perfomancës të përcaktuar me këtë UA) dhe të ketë përfunduar 100 orë trajnim gjatë kohës së mbajtjes së licencës së karrierës (të përcaktuara me Kornizën strategjike për zhvillimin e mësimdhënësve në Kosovë).</p> <p>Neni 18 Kriteret për lëshimin e licencës së mësimdhënësit të avancuar</p> <p>1. Licenca e mësimdhënësit të avancuar</p>	<p>2. After one year of experience in the teacher's profession they apply for career license with the following evidences:</p> <p>2.1. Diploma of qualification;</p> <p>2.2. Certificate for one year work in pre-university education institutions in the qualification subject/area;</p> <p>2.3. Assessment report for the school principal.</p> <p>3. Licence of career teacher should be renewed after five years on condition that teacher to show positive results of performance (level: satisfactory performance in terms of the scale of performance assessment determined by this AI) and to have completed 100 hours of training during the duration of the career license (as defined in the Strategic Framework for Teacher Development in Kosovo).</p> <p>Article 18 Criteria for license issuance of the advanced teacher</p> <p>1. License of the advanced teacher is issued</p>	<p>2. Posle jednogodišnjeg iskustva u profesiji nastavnici se prijavljuju za licencu karijere sa sledećim dokazima:</p> <p>2.1. Diploma o kvalifikaciji;</p> <p>2.2. Ugovor o jednogodišnjem radu u institucije pre - univerzitetskog obrazovanja iz predmet \ oblast kvalifikacije;</p> <p>2.3. Izveštaj o proceni od strane direktora škola.</p> <p>3. Licenca nastavnika karijere treba da se obnavljati svake pet godine pod uslovom da nastavnik pokazuje pozitivne rezultate performanse (nivo: zadovoljavajući nivo performanse u smislu stepen procene utvrđene ovom AU) i da je završio 100 sati obuke u vreme održavanje licence u karijeri (definisano u Strateškom okviru za razvoj nastavnika na Kosovu).</p> <p>Član 18 Kriterijumi za izdavanje licence napredan nastavnik</p> <p>1. Licenca napredan nastavnik izdaje se</p>
--	--	--

<p>i lëshohet mësimdhënësit i cili plotëson këto kërkesa:</p> <p>1.1. Posedon licencë të mësimdhënësit të karrierës së paku në një periudhë prej pesë vitesh;</p> <p>1.2. Ka përfunduar së paku 300 orë trajnim gjatë kohës së mbajtjes së licencës së mësimdhënësit të karrierës (të akumuluara nga programet trajnuese të miratuara nga viti 2010), prej të cilave 100 orë trajnim në programet e trajnimit për licencë të mësimdhënësit të avancuar (të përcaktuara me Kornizën strategjike për zhvillimin e mësimdhënësve në Kosovë);</p> <p>1.3. Tregon rezultate pozitive të performancës (së paku nivel të mirë të performancës në kuptim të shkallës së vlerësimit të performancës të përcaktuar me këtë UA).</p> <p>2. Licenca e mësimdhënësit të avancuar është valide për 5 vite dhe ripërtërihet pas vlerësimit të performancës (mësimdhënësi tregon së paku nivel të mirë të performancës në kuptim të shkallës së vlerësimit të performancës të përcaktuar me këtë UA).</p>	<p>to a teacher who meets these requirements:</p> <p>1.1. Possesses a career teacher license for at least a period of five years;</p> <p>1.2. It has completed at least 300 hours of training during the time of a career teacher's license (accumulated from training programs approved in 2010), of which 100 hours of training in advanced training license in training programs (defined by Strategic Framework for Teacher Development in Kosovo);</p> <p>1.3. Shows positive performance results (at least a good performance level in terms of the degree of performance assessment determined by this AI).</p> <p>2. The advanced teacher's license is valid for 5 years and is renewed after performance assessment (the teacher shows at least a good level of performance in terms of the degree of performance assessment determined by this AI).</p>	<p>nastavniku koji ispunjava sledeće zahteve:</p> <p>1.1. Poseduje licencu za nastavnika karijere u periodu trajanja najmanje od pet godina;</p> <p>1.2. Završio je najmanje 300 sati obuke za vreme trajanja licence nastavnika karijere (akumulirane iz programe obuke odobrenih u 2010 godine), od čega 100 sati obuke u programima obuke za licencu napredan nastavni (definisano u Strateškom okviru za razvoj nastavnika na Kosovu);</p> <p>1.3. Pokazuje pozitivne rezultate performanse (najmanje dobar nivo performanse u smislu stepen procene performanse određenog ovom AU).</p> <p>2. Licenca naprednog nastavnika je validna 5 godine i obnavlja se nakon vrednovanje performanse (nastavnik pokazuje najmanje dobar nivo performanse u smislu stepena ocenjivanja performanse definisano u ovoj AU).</p>
---	---	---

Neni 19 Kriteret për lëshimin e licencës së mësimdhënësit mentor	Article 19 Criteria for license issuance of the mentor teacher	Član 19 Kriterijumi za izdavanje licence nastavnik mentor
<p>1. Licenca e mësimdhënësit mentor i lëshohet mësimdhënësit që plotëson këto kërkesa:</p> <p>1.1. Posedon licencë të mësimdhënësit të avancuar në një periudhë prej së paku 5 vitesh;</p> <p>1.2. Të ketë përfunduar 200 orë trajnim gjatë kohës së mbajtjes së licencës së mësimdhënësit të avancuar gjatë 5 vjetëve, prej të cilave 100 orë trajnim në programet e trajnimit për licencë të mësimdhënësit mentor;</p> <p>1.3. Tregon rezultate pozitive të performancës (nivel i shkëlqyeshëm i performancës në kuptim të shkallës së vlerësimit të përcaktuar me këtë UA);</p> <p>1.4. Ofron një rekomandim të shkruar nga drejtori i shkollës i cili argumenton angazhimet e mësimdhënësit për aktivitetet e zhvillimit të cilësisë në shkollë, përtëj punës me nxënës.</p>	<p>1. License of the mentor teacher is issued to the teacher that meets these requirements:</p> <p>1.1. Possesses advance teacher's license in a period of at least 5 years;</p> <p>1.2. To have completed 200 training hours during the time of the retention of the advanced teacher's license over 5 years, of which 100 training hours in the training programs for license of the mentor teacher;</p> <p>1.3. It shows positive performance results (excellent performance level in terms of assessment scale determined by this AI);</p> <p>1.4. Provides a written recommendation from the school principal who argues the teacher's engagement on quality development activities at school beyond the work with students.</p>	<p>1. Licenca nastavnik mentor izdaje se nastavicima koji ispunjavaju sledeće zahteve:</p> <p>1.1. Poseduje licencu naprednog nastavnika u period najmanje od 5 godine;</p> <p>1.2. Da je završio 200 sati obuke za vrieme do je posedovao licencu naprednog nastavnika u trajanju od 5 godine, od čega 100 sati obuke za programe obuke nastavnika za licencu nastavnika mentora.</p> <p>1.3. Pokazuje pozitivne rezultate performanse (Odličan nivo performansi u smislu stepena ocenjivanje određeno ovom AU);</p> <p>1.4. Pruža pismenu preporuku od strane direktora škole kojoj argumentuje angažman nastavnika o aktivnostima za razvoj kvaliteta u školi mimo rad sa učenicima.</p>

<p>2. Licenca e mësimdhënësit mentor është valide për 5 vite dhe ripërtërihet pas vlerësimit pozitiv të performancës (tregon nivel të shkëlqyeshëm të performancës në kuptim të shkallës së vlerësimit të performancës të përcaktuar me këtë UA) dhe plotësimit të së paku 200 orëve të reja të trajnimit.</p> <p>3. Mësimdhënësit që kanë përvojë pune mbi 10 vite në cilësinë e mësimdhënësit dhe marrin licencë të avancuar sipas këtij UA, mund të aplikojnë për licencë të mësimdhënësit mentor, pa pasur nevojë të presin afatin e rregullt kohor pesëvjeçar që i plotëson kërkesat për licencë të mësimdhënësit mentor.</p> <p>Neni 20 Kriteret për lëshimin e licencës së mësimdhënësit të merituar</p> <p>1. Licenca e mësimdhënësit të merituar i lëshohet mësimdhënësit që i plotëson këto kërkesa:</p> <p>1.1. Posedon licencë të mësimdhënësit mentor për një periudhë prej së paku 10 vitesh;</p> <p>1.2. Të ketë përfunduar 450 orë trajnim pas marrjes së licencës së parë për</p>	<p>2. The mentor teacher's license is valid for 5 years and is renewed after a positive assessment performance (shows an excellent level of performance in terms of the degree of assessment performance defined by this AI) and the completion of at least 200 new training hours.</p> <p>3. Teachers who have more than 10 years of work experience as teachers and receive an advanced license under this AI can apply for a mentor teacher's license without having to wait for a regular five-year timeframe and that meets the requirements for a license of the mentor teacher.</p> <p>Article 20 Criteria for license issuance of the meritorious teacher</p> <p>1. License of meritorious teacher is issued to the teacher that meets these requirements:</p> <p>1.1. Possesses the license of the mentor teacher for a period of at least 10 years;</p> <p>1.2. To have completed 450 training hours after obtaining the first licence of</p>	<p>2. Licenca za nastavnik mentor je validna 5 godine i obnavlja se nakon pozitivne evaluacije performanse (pokazuje odličan nivo performansi u smislu stepena evaluacije vrednovanje definisano u ovoj AU) i završetak najmanje 200 novih časova obuke.</p> <p>3. Nastavnici koji imaju radno iskustva 10 godina u svojstvu nastavnika i dobijaju naprednu licencu prema ovoj AU, mogu podnijeti zahtev za izdavanje licence nastavnika mentora, bez potrebe da čekaju redovan petogodišnji vremenski rok kojime se ispunjava zahtev za licencu nastavnika mentora.</p> <p>Član 20 Kriterijumi za izdavanje licence zasluzni nastavnik</p> <p>1. Licenca zasluzenog nastavnika izda je se nastavniku koji ispunjava sledeće zahteve:</p> <p>1.1. Poseduje licencu nastavnik mentor u trajanju najmanje 10 godina;</p> <p>1.2. Da je završio 450 sati obuke nakon dobijanja prve licence mentora, od čega</p>
--	---	---

<p>mësimdhënës mentor, prej të cilave 100 orë trajnim në programet e trajnimit për licencë të mësimdhënësit meritör, dhe</p> <p>1.3. Tregon rezultate pozitive të performancës (nivel i shkëlqyeshëm i performancës në kuptim të shkallës së vlerësimit të përcaktuar me këtë UA).</p> <p>2. Licenca e mësimdhënësit të merituar është e përhershme.</p> <p>Neni 21</p> <p>Kalimi në nivel më të ulët dhe revokimi i licencës</p> <p>1. Kalimi në nivel më të ulët të licencës, nga licenca e avancuar në licencë të karrierës, apo nga licenca mentor në licencë të avancuar respektivisht licencë të karrierës, bëhet në rastet kur mësimdhënësi nuk demonstron plotësimin e kërkesave minimale të performancës për licencën e caktuar.</p> <p>2. Mësimdhënësi me licencë të rregullt të karrierës, në rast se me vlerësim të performancës nuk i plotëson kërkesat minimale për përtërirje të licencës, rekomandohet që brenda një viti të ndjekë programe shtesë të aftësimit.</p>	<p>the mentor teacher, of which 100 training hours in training programs of the meritorious teachers, and</p> <p>1.3. Shows positive performance results (Excellent performance level in terms of the assessment scale determined by this AI).</p> <p>2. License of the meritorious teacher is permanent.</p> <p>Article 21</p> <p>Transition into a lower level and license revocation</p> <p>1. Transition into a lower level of the license from the advance level in career level, or from the mentor license into the advance license is done in cases when teacher does not demonstrate fulfilment of minimum performance requirements for a certain licence.</p> <p>2. The teacher with regular career license, if, with a performance assessment does not meet the minimum requirements for renewal of the license, it is recommended that within one year to attend additional training programs.</p>	<p>100 sati obuke u programima obukeza licencu nastavnik mentor i</p> <p>1.3. Rikazuje pozitivne rezultate performanse (Odličan nivo performanse u smislu stepen procene odredene ovom AU).</p> <p>2. Licenca zasluženog nastavnika je trajna.</p> <p>Član 21</p> <p>Prelazak na niži nivo i oduzimanje licence</p> <p>1. Prelazak na niži nivo licence, od napredne licence na licenci karijere ili licenca za mentora na naprednu licencu odnosno licenca krijere, dešava se u slučajevima kada nastavnik ne pokaže ispunjenje minimalnih zahtjeva performanse za određenu licencu.</p> <p>2. Nastavnik sa redovnom licencom karijere, ako prilikom vrednovaenj performse ne ispunjava minimalne uslove za obnovu licence, preporučuje se da u roku od jedne godine pohađaju dodatne programe obuke.</p>
---	---	--

<p>3. Me përfundimin e programeve shtesë të aftësimit, të rekomanduara në pikën 2 të këtij nenit, mësimdhënësi bën kërkesë për rivlerësim të performancës. Nëse edhe në këtë rast nuk plotësohen kërkesat minimale të performancës, mësimdhënësit i merret licenca dhe detyrohet t'u nënshtrohet procedurave të rikualifikimit, varësisht nga rekomandimi i dalë në reportin e vlerësimit të performancës.</p> <p>4. Në raste të veçanta, mësimdhënësit i merret licenca për shkak të shkeljes së dispozitive ligjore, procedura fillon me rekomandim të menaxhmentit të shkollës dhe me kërkesë të DKA-së drejtuar Inspektoratit të Arsimit.</p> <p>5. Procedurën përkthim në nivel më të ulët dhe revokim të licencës e udhëheq Inspektorati i Arsimit.</p> <p>Neni 22 Aplikimi për ripërtërirje ose avancim në licencë</p> <p>1. Vlerësimi i performancës së mësimdhënësve për ripërtërirjen e parë të licencës së karrierës, bëhet sipas kriterieve të përcaktuara në planin e punës së Inspektoratit të Arsimit:</p> <p>1.1. Viti i aplikimit për licencë të</p>	<p>3. Upon completion of the additional training programs, recommended in point 2 of this Article, the teacher submits a request for performance re-assessment. If even in this case the minimum performance requirements are not met, the teacher gets the license and is obliged to undergo the retraining procedures, depending on the recommendation outlined in the performance appraisal report.</p> <p>4. In special cases, the license is obtained from the teacher due to violation of the legal provisions, the procedure begins with the recommendation of the school management and at the request of the MED addressed to the Education Inspectorate.</p> <p>5. The return procedure to the lowest level and the revocation of the license is led by the Education Inspectorate.</p> <p>Article 22 Application for renewal or advancement in the license</p> <p>1. Teachers assessment performance for the first renewal of the career license is done according to the criteria set out in the work plan of the Education Inspectorate:</p> <p>1.1. Application year for the career</p>	<p>3. Po završetku dodatnih programa obuka, preporučeno u tački 2 ovog člana, nastavnik podnosi zahtjev za ponovnu procenu performanse. Ako se čak ni u ovom slučaju nisu ispunjeni minimalni zahtevi za performansu, nastavniku se oduzima licenca i obavezan je da podleže proceduri prekvalifikacije, u zavisnosti od preporuke navedene u izveštaju o proceni performanse.</p> <p>4. U posebnim slučajevima nastavniku se oduzima licenca za nastavnika zbog kršenje zakonskih odredbi, procedura počinje sa preporukom menadžmenta škole i na zahtev ODO-a uz obraćanje Inspektoratu za obrazovanje.</p> <p>5. Procedura vraćanja na niži nivo i oduzimanje licence predvodi Inspektorat za obrazovanje.</p> <p>Član 22 Aplikacija za obnavljanje ili unapređenje licence</p> <p>1. Vrednovanje performansi nastavnika za prvu obnovu licence karijere vrše se prema kriterijumima utvrđenim u planu rada Inspektorata za obrazovanje.</p> <p>1.1. Godina prijave za licencu karijere;</p>
--	--	--

<p>karrierës;</p> <p>1.2. Orët e trajnimit sipas Kornizës strategjike për zhvillimin e mësimdhënësve në Kosovë;</p> <p>1.3. Kërkesa, ankesa e palës së tretë;</p> <p>1.4. Fusha kurrikulare, niveli i shkollimit,</p> <p>1.5. Rezultatet e testeve të jashtme, etj.</p> <p>2. Procedurat për VPM të mësimdhënësit qëapplikon për avancim në sistemin e karrierës;</p> <p>2.1. Procedurat fillojnë me aplikimin zyrtar të mësimdhënësit për avancim në sistemin e karrierës;</p> <p>2.2. Aplikimi për avancim në sistemin e karrierës bëhet sipas kritereve dhe proceduarave të përcaktuara me UA për sistemin e licencimit të mësimdhënësve dhe thirrjes publike të bërë nga MASHT përmes Inspektoratit të Arsimit.</p> <p>2.3. Pas aplikimit të mësimdhënësit për avancim në sistemin e karrierës, respektohen të gjitha procedurat e</p>	<p>license;</p> <p>1.2. Training hours according to the Strategic Framework for Teacher Development in Kosovo;</p> <p>1.3. Request, third party complaint;</p> <p>1.4. The curriculum area, the level of education,</p> <p>1.5. Results of external tests, etc.</p> <p>2. Procedures for the Teacher's EP applying for advancement in the career system:</p> <p>2.1. The procedures start with the official application of the teacher for advancement in the career system;</p> <p>2.2. The application for advancement in the career system is done according to the criteria and procedures defined by the AI for the system of the teachers licensing and the public call made by MEST through the Education Inspectorate;</p> <p>2.3. After the application of the teacher for advancement in the career system, all the procedures set out in article 11,</p>	<p>1.2. Sati obuke u skladu sa Strateškim okvirom za razvoj nastavnika na Kosovu;</p> <p>1.3. Zahtev, žalba treće strane;</p> <p>1.4. Oblast kurikuluma, nivo obrazovanja,</p> <p>1.5. Rezultati eksternih testova, itd.</p> <p>2. Procedure za VPN nastavnika koje se primjenjuju za unapređenje u sistem karijere:</p> <p>2.1. Procedure počinju zvaničним apliciranjem nastavnika za napredovanje u karijeri;</p> <p>2.2. Aplikacija za napredovanje u sistem karijere vrši se prema kriterijumima i procedurama definisanim ovoj AU za sistem licenciranje nastavnika i javnog poziva od strane MONT-a kroz Inspektorat za obrazovanje.</p> <p>2.3. Nakon aplikacije podnete od strane nastavnika za napredovanje u sistemu karijere, poštjuj se sve procedure</p>
--	---	--

<p>përcaktuara në nenin 11, duke filluar nga përgatitja e planit për VPM për avancim në sistemin e karrierës.</p>	<p>starting with the preparation of the TEP plan for advancement in the career system;</p>	<p>navedene u članu 11, počevši od pripreme plana za VPN za napredovanje u sistemu karijere;</p>
<p>3. Për përtërirjen e parë të licencës së karrierës, zbatohet sistemi i vlerësimit të performancës së mësimdhënësve i kombinuar - i brendshëm dhe i jashtëm, sipas kriterieve dhe procedurave të përcaktuara me këtë UA.</p>	<p>3. For the first renewal of the career licensing, the combined - internal and external teacher's performance assessment system is implemented, according to the criteria and procedures established by this AI.</p>	<p>3. Za prvu obnovu licence karijere, primenjuje se kombinovani sistem ocenjivanja performansi nastavnika - interno i eksterno, prema kriterijumima i procedurama navedenim u ovoj AU.</p>
<p>4. Procedurat e VPM për ripërtërirje të dytë apo të tretë të licencës të detajohen me një udhëzues të veçantë, pas përbilljes së VPM për përtërirje të parë të licencës së karrierës.</p>	<p>4. TPE procedures for second or third renewal of the license are detailed with a special guideline, after the conclusion of TPE for the first renewal of the career license.</p>	<p>4. VPN procedure za drugo ili treće obnavljanje licence obrazloženo je u posebnim vodičem nakon okončanja VPN za prvu obnovu licence karijere.</p>
<p>5. Vlerësimi i performancës për avancim në karierë është vlerësim i kombinuar - i brendshëm dhe i jashtëm i cili bëhet me kërkesë të mësimdhënësít dhe realizohet sipas kriterieve dhe procedurave të përcaktuara me këtë UA.</p>	<p>5. Performance assessment for career advancement is a combined assessment - internal and external, which is done at the request of the teacher and is carried out according to the criteria and procedures established by this AI.</p>	<p>5. Vrednovanje performanse za napredak u karijera je kombinovani sistem vrednovanje - interno i eksterno, koja se vrši na zahteve nastavnika i sprovodi se prema kriterijumima i procedurama navedenim u ovoj AU.</p>
<p>6. Për përtëritjen e licencës së mësimdhënësít të avancuar zbatohet sistemi i vlerësimit të performancës së mësimdhënësve i kombinuar - i brendshëm dhe i jashtëm, sipas kriterieve dhe procedurave të përcaktuara me këtë UA.</p>	<p>6. For the renewal of the Advanced Teacher's License is implemented the combined performance assessment system of teachers - internal and external, according to the criteria and procedures set out with this AI.</p>	<p>6. Za obnovu Licence napredna nastavnik primenjuje se kombinovani sistem za vrednovanje performanse nastavnika - interno i eksterno, prema kriterijumima i procedurama navedenim u ovoj AU.</p>
<p>7. Për përtëritjen e licencës së mësimdhënësít mentor, zbatohet sistemi i vlerësimit të performancës së mësimdhënësve</p>	<p>7. For the renewal of the mentor's teacher's license, is implemented the combined performance assessment system for teachers -</p>	<p>7. Za obnovu Licence nastavnik mentor, primenjuje kombinovani sistem vrednovanja performanse nastavnika - interno i eksterno,</p>

<p>i kombinuar - i brendshëm dhe i jashtëm, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara me këtë UA.</p>	<p>internal and external, according to the criteria and procedures set out with this AI.</p>	<p>prema kriterijumima i procedurama utvrđenim u ovoj AU.</p>
<p>Neni 23 Angazhimi i ekspertëve dhe vlerësuesve të jashtëm</p> <p>1. Inspektorati i Arsimit angazhon ekspertë dhe vlerësues të jashtëm, varësisht nga nevoja për kryerje të aktiviteteve të specializuara që lidhen me vlerësimin e performance-s së mësimdhënësve, ashtu siç është caktuar në këtë UA.</p> <p>2. Ekspertët dhe vlerësuesit e jashtëm do të jenë pjesë e ekipeve të inspektorëve për vlerësim të performancës së mësimdhënësve dhe do të shërbejnë si ekspertë këshillues për inspektorët përgjegjës.</p> <p>2.1. Ekspertë të jashtëm zgjedhen mësimdhënësit e dalluar, njohës të mirë të fushës dhe/apo lëndës mësimore. Këta do të angazhohen në rast se gjatë monitorimit në orë inspektori vëren se mësimdhënësi nuk është njohës i mirë i lëndës së vet, ose në raste kur ka ankesa nga nxënësit, prindërit, shkolla, etj.</p> <p>2.2. Vlerësuesit e jashtëm janë ekspertë të jashtëm të cilët janë njohës të procesit</p>	<p>Article 23 Engagement of the external experts and evaluators</p> <p>1. The Education Inspectorate engages experts and external evaluators, depending on the need to perform specialized activities related to teacher performance assessment as set out in this AI.</p> <p>2. The external experts and evaluators will be part of inspectors' teams for teacher performance assessment and will serve as advisory experts for the inspectors in charge.</p> <p>2.1. Distinguished teachers are selected as external experts, good acquaintances of the field and / or subject. These will be engaged if during the monitoring in the hour the inspector notes that the teacher is not a good acquaintance of his subject or in cases where there are complaints from students, parents, schools, etc.</p> <p>2.2. External evaluators are external experts who are familiar with the Teacher</p>	<p>Član 23 Angažovanje spoljnih eksperata i ocenjivača</p> <p>1. Inspektorat za obrazovanje angažuje spoljne eksperte i eksternih ocenjivače, u zavisnosti od potrebe za obavljanjem specijalizovanih aktivnosti u vezi procene performanse nastavnika, kako je navedeno u ovoj AU.</p> <p>2. Stručnjaci i spoljni ocenjivači će biti deo tima inspektora za vrednovanje performanse nastavnika i poslužiće kao savetodavni eksperti za odgovorne inspektore.</p> <p>2.1. Spoljni eksperti biraju istaknute nastavnike, dobre poznavaoce oblastri i / ili predmete. Oni će biti angažovani ako prilikom praćenja na čas inspektor primeti da nastavnik nije dobar poznavalac svog predmeta, ili ako ima pritužbe od učenika, roditelja, škola itd.</p> <p>2.2. Spoljni ocenjivači su eksperti koji su poznavaoi procesa procene</p>

<p>të Vlerësimit të Performancës së Mësimdhënësve. Vlerësuesit e jashtëm duhet të kenë të paktën licencën e mësimdhënësit të avancuar.</p>	<p>Performance Assessment process. External evaluators must have at least an Advanced Teacher License.</p>	<p>performanse nastavnika. Spoljni ocenjivači moraju imati najmanje licencu napredan nastavik.</p>
<p>3. Përgjedhja e ekspertëve dhe vlerësuesve të jashtëm bëhet përmes thirrjes publike, sipas kriterieve përkatëse. Kandidatët e përgjedhur do të trajnohen për vlerësim të performancës.</p>	<p>3. Selection of the external experts and evaluators is done through public call, according to relevant criteria. The selected candidates will be trained for performance assessment.</p>	<p>3. Zbor spoljne eksperte i ocenjivačke se vrši putem javnog poziva, prema odgovarajućim kriterijumima. Odabrani kandidati će biti obučeni za procenu performanse.</p>
<p>4. Punët dhe detyrat e vlerësuesve të jashtëm janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> 4.1. Asistimi në vlerësimin e përgatitjes dhe planit mësimor të mësimdhënësit; 4.2. Asistimi në vëzhgim të orës mësimore; 4.3. Asistimi në përgatitje të raportit; 4.4. Asistimi dhe/ose monitorimi i shkollave gjatë vlerësimit të brendshëm të VPM-ës; 4.5. Punë dhe detyra tjera që e angazhon inspektori përgjegjës e që kanë të bëjnë me procesin e vlerësimit të performancës së mësimdhënësve. 	<p>4. Works and duties of external evaluator are:</p> <ul style="list-style-type: none"> 4.1. Assistance in assessing the teacher's preparation and teaching plan; 4.2. Assistance in observation of teaching hour; 4.3. Assistance in report preparation; 4.4. Assistance and / or monitoring the schools during internal assessment of TPE; 4.5. Other works and duties that the inspector in charge engages it and dealing with the teachers performance assessment process. 	<p>4. Rad i zadaci spoljnih ocenjivača su:</p> <ul style="list-style-type: none"> 4.1. Pomoć u vrednovanju pripreme nastavnog plana nastavnika; 4.2. Pomoć u praćenju anstavnog časa; 4.3. Pomoć u pripremi izveštaja; 4.4. Pomoć i / ili monitoring škola tokom interne evaluacije VPN-a; 4.5. Druge dužnosti i zadaci za koje ga angažuje odgovorni inspektor a koje se odnose na procenu performanse nastavnika.
<p>5. Ekspertët e jashtëm do të merren me</p>	<p>5. The external experts will deal with</p>	<p>Spoljni eksperti će se baviti</p>

<p>vlerësimin e përbajtjes së lëndës/fushës, pra me vlerësimin e përbajtjes lëndore. Punët dhe detyrat e ekspertëve të jashtëm janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> 5.1. Asistimi në vlerësimin e orës mësimore; 5.2. Asistimi në vlerësimin e përgatitjes dhe planit mësimor të mësimdhënësit; 5.3. Asistimi në përgatitje të raportit; 5.4. Punë dhe detyra tjera që e angazhon inspektori përgjegjës e që kanë të bëjnë me procesin e vlerësimit të performancës së mësimdhënësve. 	<p>assessment of the subject/field content, so, with assessment of subject content. Works and duties of the external evaluator are:</p> <ul style="list-style-type: none"> 5.1. Assistance in assessment of teaching hour; 5.2. Assistance in assessment of the teacher's preparation and teaching plan; 5.3. Assistance in the report preparation; 5.4. Other works and duties that the inspector in charge engages it and dealing with the teachers performance assessment process. 	<p>ocenjivanjem sadržaja predmeta / oblasti, dakle procena sadržaja predmeta. Zadaci i dužnosti spoljnih ekspetrata su:</p> <ul style="list-style-type: none"> 5.1. Pomoć u ocenjivanju anstavnog časa; 5.2. Pomoć u proceni pripreme nastavnog plana nastavnika; 5.3. Pomoć u pripremi izveštaja; 5.4. Druge dužnosti i zadaci za koje ga angažuje odgovorni inspektor a koje se odnose na procenu performanse nastavnika.
<p>Neni 24 Ankimimi</p> <ul style="list-style-type: none"> 1. Pala e pakënaqur me raportin përfundimtar të VPM ka të drejtë ankesë. 2. Pala e pakënaqur me raportin e vlerësimit të brendshëm ka të drejtë ankesë në Sektorin përkatës të Inspektoratit të Arsimit. 3. Në rastin kur mësimdhënësi është i pakënaqur me rezultatin e vlerësimit të brendshëm, ai/ajo ka të drejtë të kërkojë 	<p>Article 24 Appeal</p> <ul style="list-style-type: none"> 1. The unsatisfied party with the final TPE report has the right to appeal. 2. The unsatisfied party with the internal assessment report has right to complaint in the relevant sector of the Education Inspectorate. 3. In the case when the teacher is unsatisfied with the internal assessment report, he/she has the right to seek external 	<p>Član 24 Žalba</p> <ul style="list-style-type: none"> 1. Stranka nezadovoljna finalnim izveštajem VPN-a ima pravo žalbe. 2. Stranka nezadovoljna izveštajem interne procene ima pravo žalbe na odgovarajući Sektor Inspektorata za obrazovanje. 3. U slučaju da je nastavnik nezadovoljan rezultatom internog vrednovanja, on ili ona ima pravo da traže

<p>vlerësim të jashtëm nga Inspektorati i Arsimit.</p> <p>4. Në rastin kur drejtori i shkollës ka vështirësi me realizimin e procesit të vlerësimit të brendshëm, ka të drejtë të kërkojë mbështetje nga DKA dhe Inspektorati i Arsimit.</p> <p>5. Pala e pakënaqur me raportin e vlerësimit të jashtëm ka të drejtë ankesë në Panelin e Artë.</p> <p>6. Vendimi i Panelit të Artë është i formës së prerë në procedurë administrative.</p>	<p>assessment from the Education Inspectorate.</p> <p>4. In case when the school principal has difficulties with the implementation of the internal assessment process, he/she has the right to seek support from the MED and the Education Inspectorate.</p> <p>5. The unsatisfied party with the external assessment process has the right to appeal at the Golden Panel.</p> <p>6. The decision of the Golden Panel is final in administrative panel.</p>	<p>spoljnju evaluaciju od Inspektorata za obrazovanje.</p> <p>4. U slučaju da direktor škole ima poteškoće u realizaciji procesa interne evaluacije imaju pravo da zahteva podršku od strane ODO i Inspektorata za obrazovanje.</p> <p>5. Stranka nezadovoljna izveštajem spoljne procene ima pravo žalbe Zlatnom panelu.</p> <p>6. Odluka Zlatnog panela je u konačna u pravni postupak.</p>
<p>Neni 25 Dispozitat shfuqizuese</p> <p>Shfuqizohet UA nr. 14/2013 dt.17.05.2013 me titull " Vlerësimi i performancës së Mësimdhënësve" si dhe dispozitat tjera nënligjore që kanë rregulluar këtë fushë e që janë në kundërshtim me këtë UA.</p>	<p>Article 25 Repealing provisions</p> <p>Is repealed AI no. 14/2013 dated 17.05.2013 titled "Teacher Performance Assessment" as well as other sub-legal provisions that have regulated this area and which are contrary to this AI.</p>	<p>Član 25 Van snažne odredbe</p> <p>Stavlja se van snage AU br.14/2013, pod nazivom „Vrenovanje“ performanse nastavnika kao i drugi podzakonski akti koji su regulisali ovu oblast i koji su suprotni ovom AU.</p>
<p>Neni 26 Shtojeat</p> <p>Pjesë e këtij UA, janë shtojeat: A, B, C, D dhe E.</p>	<p>Article 26 Appendixes</p> <p>Parts of this AI are appendixes: A, B, C, D and E.</p>	<p>Član 26 Dodatak</p> <p>Deo ove AU su i dodatak A,B,C,D i E .</p>

Shtojca A: Fushat profesionale, standardeve dhe treguesit

Lidhja në mes të fushave të mësimdhënies, standardeve dhe treguesve të performancës pasqyrohet në tabelën në vijim e cila i paraqet kriteret që do të përdoren për t'i vlerësuar mësimdhënësit për licencim, rilicencim dhe avancim:

Fushat	Standarde	Treguesit
Vlerat profesionale, qëndrimet dhe sjelljet	1. Njeh dhe i mbështet vlerat dhe kriteret kryesore që janë vendosur nga MASHT-i /Përgjegjësi karshi detyrimeve dhe obligimeve të punës.	<ul style="list-style-type: none"> 1.1. Bazon praktikën e mësimdhënies në vlerat dhe parimet e Kornizës së Kurrikulës së Kosovës dhe kodin e sjelljes të MASHT-it 1.2. I kryen detyrat dhe obligimet e mësimdhënies me profesionalizëm, përkushtim të lartë, ndershmërisë dhe saktësisë 1.3. E njeh dhe i respekton kërkesat ligjore, administrative dhe organizative të profesionit, duke e përfshirë orarin mësimor, menaxhimin e kohës
Njohuritë dhe kuptimi profesional	2. Demonstron qëndrime dhe sjellje pozitive dhe objektive përmirësuar e nxënësve dhe mësimit.	<ul style="list-style-type: none"> 2.1. Kuption zhvillimin fizik, social dhe intelektual të nxënësve dhe e promovon mësimin gjatë gjithë jetës 2.2. I njeh nxënësit se si mësojnë, si dhe i përkrah në arritjen e rezultateve mësimore 2.3. I trajton të gjithë nxënësit në mënyrë të barabartë dhe me respekt 2.4. Krijon mjedis të sigurt dhe mbështetës mësimor, që e rrit nxënien dhe i inkurajon nxënësit që të bëhen persona që i zgjidhin problemet, që janë vendimmarrës, që mësojnë gjatë tërë jetës, si dhe që bëhen pjesëtarë të dobishëm të shoqërisë

	3. Demontron njohje të kurrikulës/përmbajtjes lëndore dhe metodikës së didaktikës profesionale të lëndës.	<p>3.1. E njeh përmbajtjen e fushës mësimore në kurrikulën e Kosovës</p> <p>3.2. Di si të jep mësim për përmbajtjen mësimore, duke shfrytëzuar teknika të ndryshme efektive</p> <p>3.3. Bën mësimdhënie të diferencuar për ta mbështetur pjesëmarrjen e të gjithë nxënësve, si dhe për t'i trajtuar nevojat e veçanta mësimore të nxënësve me aftësi të ndryshme</p> <p>3.4. Zotëron strategji të ndryshme për menaxhimin e klasës</p>
Shkathësitë dhe praktikat profesionale	4. Planifikon zbatim efektiv të mësimdhënieς dhe mësimnxënies.	<p>4.1. Përcakton qëllime sfiduese të mësimit;</p> <p>4.2. Përdor strategji të llojiljojshme të mësimdhënieς për t'i motivuar nxënësit dhe nxisë të menduarit e nivelit të lartë</p> <p>4.3. I përzgjedh dhe i shfrytëzon burimet e duhura; Krijon materiale mësimore për temat e caktuara ku mungon literatura</p> <p>4.4. Përdor teknologji adekuate në mënyrë adekuate – sigurt, me përgjegjësi dhe me etikë</p>
	5. Planifikon vlerësimin e vazdueshëm (vlerësimin për të mësuar), ofron komente kthyese dhe raporton sa i përket mësimit të nxënësve.	<p>5.1. E vlerëson vazhdimesh progresin e nxënësve si dhe komunikon shpesh me nxënësit për t'iu ofruar informata kthyese në mënyrë konstruktive</p> <p>5.2. Planifikon plotësimin e zbrazëtive te të arriturat e nxënësve</p> <p>5.3. I interpreton të dhënat nga vlerësimi i nxënësve për të përmirësuar nxenien e tyre</p> <p>5.4. Raporton sa i përket arritjeve të nxënësve</p>
Mësimi dhe angazhimi profesional	6. Angazhohet për zhvillim të vazdueshëm profesional.	<p>6.1. I identifikon dhe i planifikon nevojat profesionale për mësim</p> <p>6.2. Përdor mësim të ri profesional për ta përmirësuar praktikën e mësimdhënieς</p> <p>6.3. Angazhohet me kolegë për ta përmirësuar praktikën e mësimdhënieς</p> <p>6.4. I përshtat dhe i përmirëson praktikat e mësimdhënieς përmes nxënies dhe reflektimit</p>

	<p>7. Angazhohet profesionalisht me kolegë, prindër dhe bashkësi.</p>	<ul style="list-style-type: none"> 7.1. Angazhohet për të krijuar mjedis bashkëpunues me kolegë 7.2. Komunikon në mënyrë efektive me nxënës, prindër/ kujdestarë dhe kolegë 7.3. Angazhohet me rrjete të ndryshme profesionale të bashkëpunimit në fushën e mësimdhënies si dhe në bashkësi më të gjera profesionale dhe i promovon njojuritë si dhe debaton për problemet relevante të fushës së arsimit 7.4. Ndërmerr hulumtime në veprim në mjedisin shkollor ku vepron
--	---	--

Shtojca B: Formulari për vetëvlerësim nga mësimdhënësi

Të dhënat për mësimdhënësin:

Numri personal i mësimdhënësit _____

Emri

Mbiemri

Klasa

Lënda

Përvoja në mësimdhënie:

Vite

Muaj

Kontakti: _____

(nr. i telefonit dhe e-mail adresë)

Të dhënat për shkollën:

Rajoni

Komuna

Emri i shkollës, vendi, adresa dhe kontakti (nr. telefoni apo email)

Vetëvlerësimi

Vetëvlerësimi bazohet në shtatë standardet e përfshira në KSZHPM. Ky instrument i ofron çdo mësimdhënësi mundësi për të reflektuar në lidhje me performancën e tij/saj profesionale. Në përputhje me natyrën formative të këtij vlerësimi, ai stimulon një vlerësim që pritet t'i motivojë veprimet e ardhshme për ta përforcuar ose përmirësuar mësimdhënien.

Ky instrument është i ndarë në dy pjesë. Në të parën do ta gjeni një seri pyetjesh që lidhen me treguesit specifik që rrjedhin nga Korniza Strategjike. Në pjesën e dytë do t'i gjeni dy pyetje të hapura që do ju mundësojnë ta shprehni vlerësimin tuaj të përgjithshëm në lidhje me performancën tuaj profesionale.

Shtatë standardet nga KSZHPM janë dhënë në Shtojcën e këtij dokumenti. Lexoni me kujdes secilin prej standardeve dhe reflektoni për praktikën tuaj të mësimdhënies. Në këtë formular vlerësimi janë dhënë shtatë grupe pyetjesh, të bazuara në secilin standard. Analizoni pyetjen dhe zgjedhni një nivel të performancës që ju mendoni se me saktësi reflekton nivelin e performancës tuaj për atë standard. Në secilën pyetje duhet të përgjigjeni me një nivel performance nga tabela vijuese (SH për shkëlqyeshëm, M për mirë, K për kënaqshëm ose P për pakënaqshëm, për të vlerësuar secilën pyetje). Pastaj, arsyetoni vlerësimin tuaj me një përgjigje të shkurtër e konkrete duke dhënë sqarime për nivelin e performancës që ju e keni zgjedhur për secilin grup pyetjesh.

Drejtori i shkollës suaj nga ana tjetër, e plotëson një instrument paralel në lidhje me performancën tuaj. Pasi ju dhe drejtori i shkollës ta keni përfunduar vlerësimin, pritet që ju të takoheni për t'i analizuar dhe krahasuar vlerësimet tuaja. Ky vetëvlerësim dhe vlerësimi nga drejtori i shkollës përbëjnë dy komponentë të vlerësimit të brendshëm për licencim.

Pjesa 1.

Orientim lidhur me pikëzimin: Mblidhni pikët për treguesit e secilit standard për ta nxjerrë rezultatin tuaj të përgjithshëm për atë standard. Rezultati juaj total për çdo standard nuk i tejkalon 2 pikë, ose maksimalisht 14 pikë nga shtatë standardet. Kjo përbën 10% të maksimumit të mundshëm nga vlerësimi i përgjithshëm (i brendshëm dhe i jashtëm). Pikët për secilin nivel të performancës janë dhënë në tabelë më poshtë:

SH 12-14 pikë.	Performanca e shkëlqyeshme: Performancë që <u>yazhdimisht demonstron cilësi të lartë</u> për standarde.
M 9-11 pikë.	Performanca e mirë: Performancë që <u>demonstron zotërim</u> të standardeve.
K 5-8 pikë	Performanca e kënaqshme: Performancë që <u>demonstron përbushje elementare</u> të standardeve.
P Nën 5 pikë.	Performanca e pakënaqshme: Performancë që <u>nuk i përbushë</u> pritshmëritë e standardeve.

Standardi 1: Njeh dhe i mbështetë vlerat dhe kriteret kryesore që janë vendosur nga MASHT-i /përgjegjësi karshi detyrimeve dhe obligimeve të punës.

- 1.1 Bazë e ka praktikën e mësimdhënies në vlerat dhe parimet e Kornizës së Kurrikulës së Kosovës dhe kodin e sjelljes së MASHT-it
- 1.2 I kryen detyrat dhe obligimet e mësimdhënies me profesionalizëm, përkushtim të lartë, ndershëmëri dhe saktësi
- 1.3 E njeh dhe i respekton kërkesat ligjore, administrative dhe organizative të profesionit, duke e përfshirë orarin mësimor, menaxhimin e kohës.

<i>Niveli i performancës për secilin kriter veç e veç.</i>	<i>Sh</i>	<i>M</i>	<i>K</i>	<i>P</i>
Notimi: <u>Sh = 1 pikë;</u> <u>M = 0.5 pikë;</u> <u>K = 0.25 pikë;</u> <u>P = 0 pikë.</u>				
1.1 Si e vlerësoj nivelin e njohurive të mia lidhur me Kornizën Kurrikulare dhe lëndën që e zhvilloj?				
1.2 Si e tregoj zotërimin për profesionin tim? Përfshini në përgjigjen tuaj:				
<ul style="list-style-type: none"> • Duke qenë i përpiktë dhe duke e respektuar orarin e punës, duke i përbushur të gjitha detyrimet e ditës së punës dhe me mungesa të pakta • Kujdesem për pronën e shkollës dhe përmjedis të pastër dhe të shëndetshëm • Ruajtja e konfidencialitetit profesional 				
<i>Totali i pikëve =</i>				

Standardi 2: Demonstron qëndrime dhe sjellje pozitive dhe objektive për mirëqenien e nxënësve dhe mësimit:

- 1.1 Kupton zhvillimin fizik, social dhe intelektual të nxënësve dhe e promovon mësimin gjatë gjithë jetës
- 1.2 I njeh nxënësit se si mësojnë, si dhe i përkrah në arritjen e rezultateve mësimore
- 1.3 I trajton të gjithë nxënësit në mënyrë të barabartë dhe me respekt
- 1.4 Krijon mjedis të sigurt dhe mbështetës mësimor, që e rrit nxënien dhe i inkurajon nxënësit që të bëhen persona që i zgjidhin problemet, që janë vendimmarrës, që mësojnë gjatë tërë jetës, si dhe që bëhen pjesëtarë të dobishëm të shoqërisë

<i>Niveli i performancës për secilin kriter veç e veç.</i>				
<i>Notimi: Sh = 1 pikë; M = 0.5 pikë; K = 0.25 pikë; P = 0 pikë.</i>	<i>Sh</i>	<i>M</i>	<i>K</i>	<i>P</i>
2.1. dhe 2.2. Si i identifikoj nevojat zhvillimore të nxënësve dhe si i adresoj ato në praktikën time të mësimdhënies.				
2.3. dhe 2.4. Si e krijoj një mjedis të sigurt, të respektueshëm dhe mbështetës për të gjithë nxënësit e mi?				
<i>Totali i pikëve =</i>				

Standardi 3: Demontron njojje të kurrikulës/përmbajtjes lëndore dhe metodikës së didaktikës profesionale të lëndës.

- 3.1 E njeh përmbajtjen e fushës mësimore në kurrikulën e Kosovës
- 3.2 Di si të jep mësim për përmbajtjen mësimore, duke shfrytëzuar teknika të ndryshme efektive
- 3.3 Bën mësimdhënie të diferencuar për ta mbështetur pjesëmarrjen e të gjithë nxënësve, si dhe për t'i trajtuar nevojat e veçanta mësimore të nxënësve me aftësi të ndryshme
- 3.4 Zoteron strategji të ndryshme për menaxhimin e klasës.

<i>Niveli i performancës për secilin kriter veç e veç.</i> Notimi: <u>Sh = 1 pikë;</u> <u>M = 0.5 pikë;</u> <u>K = 0.25 pikë;</u> <u>P = 0 pikë.</u>	<i>Sh</i>	<i>M</i>	<i>K</i>	<i>P</i>
3.1. dhe 3.2. Si i demonstroj njojuritë e mia për lëndën dhe mënyrën si ta ligjerojë atë?				
3.3. dhe 3.4. Si i përdorë strategjitet e ndryshme të mësimdhënies për ta mbështetur pjesëmarrjen gjithpërfshirëse të nxënësve dhe nevojat për mësimnxëniet?				
<i>Totali i pikëve =</i>				

Standardi 4: Planifikon zbatimin efektiv të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

- 1.1. Përcakton qëllime sfiduese të mësimit
- 1.2. Përdor strategji të llojlojshme të mësimdhënies për t'i motivuar nxënësit dhe nxisë të menduarit e nivelit të lartë
- 1.3. I përgjedh dhe i shfrytëzon burimet e duhura
- 1.4. Krijon materiale mësimore për temat e caktuara ku mungon literatura. Përdor teknologji adekuate në mënyrë adekuate – sigurt, me përgjegjësi dhe me etikë

<i>Niveli i performancës për secilin kriteri veç e veç.</i>	<i>Sh</i>	<i>M</i>	<i>K</i>	<i>P</i>
Notimi: <u>Sh = 1 pikë;</u> <u>M = 0.5 pikë;</u> <u>K = 0.25 pikë;</u> <u>P = 0 pikë.</u>				
4.1. dhe 4.2. Si i përdorë strategjitet mësimore për t'i sfiduar nxënësit dhe për ta nxitur nivelin më të lartë të të menduarit.				
4.3. dhe 4.4. Si i përdorë materialet dhe burimet mësimore të përshtatshme, përfshirë teknologjinë?				
<i>Totali i pikëve =</i>				

